



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr, Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

U.D. Rektor
Prof. Dr. Anton Berishaj

Nr. Prot.: 11546
Datë: 30-7-2014

Mbështetur në nenin 25 dhe 28 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe konsultimeve me të gjitha palët relevante, përfshirë dekanët e njësive akademike, Rektori (u.d.) mori:

VENDIM

- I. Dosja e të gjithë studentëve të diplomuar në Universitetin e Prishtinës, para se të marrin certifikatën dhe diplomën, duhet të përmbajë këto dokumente:
 1. Transkriptin e notave;
 2. ID-kartelën e studentit; dhe
 3. Deklaratën e konfirmimit.
- II. Transkripti i notave duhet të verifikohet nga Zyrtari i shërbimit për studentë në Fakultetin përkatës dhe duhet të barazohet me procesverbalet e profesorëve për të gjitha notat që gjenden në transkript të studentit.
- III. Zyrtari i shërbimit për studentë duhet të nënshkruajë deklaratën që konfirmon se transkripti i studentit, i arkivuar në dosje, është identik me notat e procesverbaleve të profesorëve të dorëzuar në afatet përkatëse të provimeve (Deklarata në pikën 3, paragrafi I i këtij Vendimi).
- IV. Certifikata e lëshuar për studentin e diplomuar arkivohet, gjithashtu, duke ju shtuar dokumentave si në pikën I të këtij Vendimi.

Arsyetim

Vendimi si në pikat I deri në IV më sipër është marrë duke u mbështetur në kompetencat e Rektorit, siç përcaktohen në nenet 25 dhe 28 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, veçanërisht ato që lidhen me autoritetin kryesor menaxhues të Rektorit dhe përgjegjësinë për sigurimin e punës efektive në Universitet. Si shtesë e këtyre kompetencave statutare të Rektorit, ky Vendim mbështetet edhe në domosdonë institucionale që ka si qëllim të sigurojë shkarkimin e anëtarëve të personelit akademik nga detyra të shtuara administrative.

Ky Vendim i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Zyrës Ligjore të UP-së.



Prof. Dr. Anton Berishaj
Rektor (u.d.)